



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/85
Datë: 15/9/2023

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", shpallë:

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master për vitin akademik 2023-2024

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 106 të Statutit, në mbledhjen e mbajtur më 6.9.2023, ka miratuar propozimet e njëjësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2023/2024 dhe ka miratuar kriteret për regjistrim në studimet themelore - master. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, gjithashtu janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejshëm MASHTI) me shkresën nr. prot. 3328, datë 14.09.2023.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", për studimet postdiplomike-master, për vitin akademik 2023-24, do të regjistrojë **2418** studentë, nga të cilët **17** studentë ndërkombëtarë.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1 të këtij konkursi duke u bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri **281** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në studimet postdiplomike-master në Universitetin e Prishtinës, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi në pranim do të kenë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet themelore-bachelor në Universitetin e Prishtinës.
4. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë edhe të gjithë kandidatët tjerë të cilët i kanë përfunduar me sukses studimet themelore jashtë Kosovës. Në raste të tilla, kandidati duhet të sjellë dëshminë (vërtetim apo vendim) mbi akreditimin e institucionit në të cilin i ka mbaruar studimet paraprake. Në pamundësi të sigurimit të dëshmisë për akreditim, atëherë (statusi i këtyre programeve do të konfirmohet nga zyra për zhvillim akademik e cila gjendet në Fakultetin Filozofik, kati II nr.107.
5. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi, Komisioni

i Studimeve i njësisë akademike cakton provime diferenciale të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Komisioni i Studimeve cakton numrin e provimeve varësisht nga shkalla e krahasueshmërisë/ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve diferenciale në afatin e qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë (5) provime diferenciale të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësisë akademike përkatëse.

6. Përrjashtim nga paragrafi 3 i pikës I të këtij konkursi bëhet për programet studimore me specifika të veçanta, të cilat i përcaktojnë vetë njësitë akademike.
7. Universiteti i Prishtinës, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e aplikimit do t'ua shtoj nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuara nga institucionet gjegjëse.
8. **Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.**
9. **Kandidatët për pranim si studentë të UP-së në vitin akademik 2023/24 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.**

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
 - Suksesi në studimet themelore deri në 30 pikë;
 - Suksesi në provimin pranues deri në 70 pikë.
2. Përveç provimeve nga lëndët profesionale, kandidatët do t'i nënshtrohen testit edhe në gjuhë angleze nga i cili mund të sigurojnë deri në 10% të pikëve të provimit pranues. Nëse kandidati dëshmon që ka certifikatë ndërkombëtare TOEFL me së paku 79 pikë (ose IELTS me së paku 5.65 pikë), i njëjti me automatizëm merr 5 pikë, ndërsa pikët tjera lidhur me gjuhën angleze shtohen varësisht nga suksesi i treguar në provimin pranues - pjesën e gjuhës angleze.
3. Përrjashtim nga paragrafi 2 i kësaj pike do të bëhet për kandidatët që aplikojnë në programet e gjuhëve të huaja në Fakultetin e Filologjisë ku provimi do të mbahet në gjuhën e programit studimor.
4. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
5. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

6. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
7. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprake. Në qoftë se edhe sukseesi është i njëjtë, atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatet i takojnë gjinisë femërore, përzgjedhja e kandidateve për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidateve me pikë të barabarta. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta. Sekretari i fakultetit përkatës është i obliguar që listën e kandidatëve të cilët kanë konkurruar, t' ia dërgoj Rektoratit të Universitetit, e gjithashtu ta publikoj në ueb-faqen e Fakultetit.
8. Në rast se mbesin vende të lira në kategorinë e komunitetit jo shumicë, për shkak që jo të gjithë kandidatët kanë arritur të kalojnë prapun minimal të pikëve, atëherë plotësimi i vendeve të rezervuara për komunitetin jo shumicë do të bëhet sipas ranglistës së pikëve me kandidatë që e kanë kaluar prapun e kalueshmërisë dhe që i takojnë komunitetit shumicë.
9. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimit ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 5-10 studentëve.

III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online <http://apliko.uni-pr.edu> hapet prej datës **15.9.2023** deri me datë **29.9.2023**, në orën **16:00**. Gjatë kësaj periudhe do të bëhet edhe dorëzimi i dokumentacionit fizik nga kandidatët. Dokumentacioni do të pranohet çdo ditë, me përjashtim të të dielave.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **15.9.2023**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **14:00**.
3. Gjatë periudhës së aplikimit do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula e noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
5. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:**
 - a) *Ekstraktin e lindjes (origjinale),*
 - b) *Diplomën origjinale, të noterizuar ose dublikatë, përkatësisht certifikatën e diplomimit-*

originale,

- c) Dëshminë e akreditimit të institucionit të arsimit të lartë (për kandidatë që kanë të mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private të Republikës së Kosovës).
- d) Fletëparaqitja e plotësuar e cila shkarkohet gjate aplikimit online nga interneti: *Vegëza (Linku) për aplikim online përmes Internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>.*
- e) Kandidatët me rastin e aplikimit, bazuar në UA 09/2021 lirohen nga pagesa e provimit pranues.

Provimi pranues do të mbahet më datë **03.10.2023** dhe **04.10.2023**, sipas orarit si në vijim:

Grupi I:

1. Fakulteti Filozofik, datë **03.10.2023** në ora 9:00
2. Fakulteti i SHMN-së, datë **03.10.2023** në ora 9:00
3. Fakulteti Ekonomik, datë **03.10.2023** në ora 9:00
4. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës, datë **03.10.2023** në ora 9:00
5. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, datë **03.10.2023** fillon në ora 9:00-12:00
6. Fakulteti i Arkitekturës, datë **03.10.2023** në ora 09:00
7. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, më **03.10.2023** në ora 8:00
8. Fakulteti i Edukimit, datë **03.10.2023** në ora 9:00.

Grupi II.

1. Fakulteti i Filologjisë, datë **04.10.2023** në ora 9:00
2. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, datë **04.10.2023** fillon në ora 9:00-11:00
3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, datë **04.10.2023** fillon në ora 9:00-11:00
4. Fakulteti Juridik, datë **04.10.2023** në ora 9:00
5. Fakulteti i Mjekësisë, datë **04.10.2023** nga ora 15:00
6. Fakulteti i Arteve, datë **04.10.2023** nga ora 9:00.

1. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet të posedojnë letërnjoftimin, pa të cilin nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

2. **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. **Shpallja e rezultateve preliminare** e provimit pranues për të dy grupet do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve, më së voni deri më datë **05.10.2023**, në ora **16:00**
2. *Rezultati preliminar nuk është rezultat përfundimtar. Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, pasi me rastin e miratimit si të bazuar të ankesës, dikush nga kandidatët mund të radhitet me lart me pikë se kandidati i radhitur sipas rezultatit preliminar.*

V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preleminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare (llogariten ditët e punës), respektivisht: për të dy grupet më së voni deri më datë **09.10.2023, në ora 16:00.**
2. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshënuar, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet, menjëherë pas mbylljes së afati ligjor për ankesa dhe atë në nivel të universitetit vetëm nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës.

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse, pas shqyrtimit të ankesave dhe atë:
 - 1.1. Për dy grupet më së voni deri më datë **10.10.2023, në ora 16:00**
2. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **10.10.2023-13.10.2023.**

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

1. Regjistrimi dhe fotografimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), sipas këtij orari:
 - Fakulteti Filozofik më **11.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, më **11.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, më **11.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Arkitekturës, më **11.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, më **12.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Edukimit, më **12.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**.
 - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, më **12.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Filologjisë, më **13.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, më **13.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, më **13.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti Juridik, më **13.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Arteve më **16.10.2023**, prej orës **9:00 - 12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti Ekonomik, më **16.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
 - Fakulteti i Mjekësisë, më **16.10.2023**, prej orës **9:00-12:00 dhe 13:00-15:00**;
2. Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **1.11.2023, në ora 16:00.** Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.

3. Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.
4. Në qoftëse kandidati i pranuar, në afatin e caktuar nuk i përfillë të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit. Vendet e mbetura vakant pas humbjes së të drejtës së regjistrimit, përkatësisht lëshimit të afatit si në paragrafin 3 të kapitullit V nuk do të zëvendësohen me kandidatë të cilët gjinden në listën e kandidatëve të pranuar.
5. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh nota mesatare e studimeve paraprake. Në qoftë se edhe sukcesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore. Në qoftë se kandidatët i takojnë gjinisë mashkullore, përzgjedhja e kandidatit për pranim do të bëhet përmes shortit nga Komisioni i Fakultetit në prezencën e kandidatëve me pikë të barabarta.

VIII. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR REGJISTRIM

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

- a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet dhe shtypet (bardh e zi) nga faja <http://apliko.uni-pr.edu>
- b) Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
- c) Sipas UA (MASHTI) Nr. 09/2021, të gjithë studentët që fillojnë studimet në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” lirohen nga pagesa e tarifës së shkollimit kur e regjistrojnë semestrin për herë të parë.

I. FAKULTETI FILOZOFIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **210** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti Filozofik	185	25	210
Departamenti i Filozofisë	35	5	40
Programi i Filozofisë	35	5	40
Departamenti Histori	53	7	60
Programi Histori e Kohës së Re	35	5	40

Programi Arkivistikë	18	2	20
Departamenti Shkenca Politike	35	5	40
Programi Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci	35	5	40
Departamenti Sociologji	26	4	30
Programi Sociologji	26	4	30
Departamenti Psikologji	36	4	40
Programi Psikologji shkollorë dhe këshillim	18	2	20
Programi Psikologji Klinike dhe Komuniteti	18	2	20

Programi Filozofi

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e filozofisë apo nga fusha e shkencave humane/sociale;
- T'i nënshtrohen testimit lidhur me njohuritë profesionale nga filozofia;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

Programi Histori e Kohës së Re

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e historisë apo nga fusha e shkencave humane/sociale;
- T'i nënshtrohen testimit lidhur me njohuritë profesionale nga studimet themelore;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

Programi Arkivistikë

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e historisë apo nga fusha e shkencave humane/sociale;
- T'i nënshtrohen testimit lidhur me njohuritë profesionale nga studimet themelore;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

Programi Marrëdhënie ndërkombëtare dhe diplomaci

- T'i kenë të përfunduara me sukses studimet themelore në shkenca politike apo shkenca humane/sociale;
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore nga fusha: E drejta ndërkombëtare; Politikë botërore; Institucionet, politikat dhe vendimmarrja e BE-së; Njohuri të përgjithshme nga shkencat humane/sociale;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

Programi Sociologji

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e sociologjisë apo shkencat sociale/humane;
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore;
- Nëse kandidati nuk ofron dëshmi për njohjen e gjuhës angleze apo të ndonjë gjuhe tjetër botërore, ai/ajo duhet t'i nënshtrohet provimit nga gjuha e huaj, që organizohet në Fakultetin Filozofik.

Programi Psikologji shkollore dhe këshillimi

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e psikologjisë;
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore në gjuhën shqipe dhe angleze.

Programi Psikologji klinike dhe shëndeti

- T'i kenë të përfunduara studimet themelore nga fusha e psikologjisë;
- T'i nënshtrohen testit të përbërë prej njohurive paraprake nga studimet themelore në gjuhën shqipe dhe angleze.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKO-NATYRORE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **195** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore	172	23	195
Departamenti Matematikë	45	5	50
Programi Matematikë me zbatime	18	2	20
Programi Shkenca Kompjuterike	27	3	30
Departamenti Fizikë	18	2	20
Programi Fizikë	18	2	20
Departamenti Kimi	39	6	45
Programi Kimi Organike	13	2	15
Programi Kimi Analitike dhe Kimi Mjedisore	13	2	15
Programi Kimi Fizike dhe Kimi Inorganike	13	2	15
Departamenti Biologji	52	8	60
Biologji	26	4	30
Programi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit	26	4	30
Departamenti Gjeografi	18	2	20
Programi Gjeografi	18	2	20

Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:

- Për programin Matematikë me zbatime provimi do të jetë nga Matematika;
- Për programin Fizikë provimi do të jetë nga Fizika;

- Për programin Gjeografi provimi do të jetë nga Gjeografia;
- Për programet Biologji dhe Ekologji me mbrojtje të mjedisit provimi do të jetë nga Biologjia;
- Për programet Kimi Organike, Kimi Fizike dhe Inorganike, Kimi analitike dhe Mjedisit provimi do të jetë nga Kimia;
- Për Programin Shkenca Kompjuterike provimi do të jetë nga Matematika dhe Shkenca Kompjuterike.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **195** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Filologjisë	172	23	195
Programi Gjuhë Shqipe	26	4	30
Programi Letërsi Shqipe	22	3	25
Programi Gjuhë Angleze - Programi i integruar i gjuhësisë	18	2	20
Programi Letërsi Angleze	13	2	15
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	18	2	20
Programi Gjermanishtja si gjuhë e huaj	13	2	15
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	18	2	20
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	13	2	15
Programi Studime Kulturore Orientale	13	2	15
Programi Gazetari dhe marrëdhënie me publikun	18	2	20

Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:

Programi Gjuhë Shqipe

1. Norma e shqipes së shkruar;
2. Fonetikë;
3. Morfologji;
4. Leksikologji;
5. Sintaksë;
6. Histori e gjuhës shqipe;
7. Sociolinguistikë; dhe
8. Psikolinguistikë.

Programi Letërsi Shqipe

1. Teori e letërsisë;
2. Letërsi e romantizmit shqiptar;
3. Letërsi moderne shqipe;

4. Letërsi botërore; dhe
5. Letërsi e sotme shqipe.

Programi Gjuhë Angleze - Programi i integruar i gjuhësisë

1. Anglishtja për qëllime akademike;
2. Analizë morfo-sintaksore; dhe
3. Metodologjia e mësimdhënies.

Programi Letërsi angleze

1. Analizë e veprës letrare; dhe
2. Letërsi moderne angleze dhe amerikane.

Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

1. Gjuhë gjermane; dhe
2. Letërsi gjermane;

Programi Gjermanishtja si gjuhë e huaj

1. Gjuhë gjermane; dhe
2. Metodikë e gjuhës gjermane.

Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge

1. Gjuhë frënge;
2. Letërsi frënge; dhe
3. Metodikë/didaktikë.

Programi Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun

1. Hyrje në gazetari;
2. Zhanret e gazetarisë;
3. Marrëdhënie me publikun; dhe
4. Bazat e komunikologjisë.

Programi Studime Kulturore Orientale

1. Qytetërim islam;
2. Kulturë orientale;
3. Historia e islamit në Ballkan; dhe
4. Letërsia shqipe e Almiados.

Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke

1. Gjuhë e sotme turke;
2. Letërsi e sotme turke; dhe
3. Zhvillimi historik i turkologjisë.

Vërejtje:

- Provimi në të gjitha programet do të mbahet me shkrim.
- Të drejtë konkurrimi në studimet e nivelit MA kanë vetëm kandidatët të cilët i kanë përfunduar studimet në fusha të përafërta.

- Përfundimisht, kandidati për pranim në programin MA Studimet kulturore orientale duhet t'i kenë përfunduar studimet themelore universitare në programet Orientalistikë, Gjuhë dhe letërsi turke, Histori, Antropologji Etnologji, Arkivistikë, Filozofi-Sociologji dhe të ketë njohuri elementare për njërin nga gjuhët arabe, turke ose perse.

IV. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **275** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti Juridik	243	32	275
E Drejta Kushtetuese dhe Administrative	31	4	35
E Drejta Civile dhe Pronësore	35	5	40
E Drejta Penale	35	5	40
E Drejta Ndërkombëtare	31	4	35
E Drejta Financiare	31	4	35
Kontrata dhe e Drejta Komerciale	31	4	35
Studimet e Avancuara Evropiane (programi në Gjuhë Angleze)	Studentë të rregullt jo ndërkombëtar	17	3
	Studentë ndërkombëtar	5	
Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale (programi në Gjuhë Angleze)	Studentë të rregullt jo ndërkombëtar	17	3
	Studentë ndërkombëtar	10	

Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:

Programi: E Drejta Kushtetuese Administrative:

1. E drejta kushtetuese;
2. E drejta administrative;
3. Fillet e së drejtës.

Programi: E Drejta Civile dhe e Pronës:

1. E drejta civile (e drejta civile pjesa e përgjithshme dhe e drejta sendore) ;
2. E drejta e detyrimeve;
3. E drejta e procedurës civile (procedura kontestimore).

Programi: E Drejta Penale:

1. E drejta penale;
2. E drejta e procedurës penale;

3. Kriminologji dhe Penologji.

Programi: E Drejta Ndërkombëtare:

1. E drejta e Bashkimit Evropian;
2. E drejta Ndërkombëtare Publike
3. E drejta Nërkombëtare Private.

Programi: E Drejta Financiare:

1. Financat dhe e drejta Financiare;
2. Ekonomia;
3. E drejta tatimore dhe buxhetore.

Programi: Kontrata dhe e Drejta Komerciale:

1. E drejta e detyrimeve;
2. E drejta tregtare (biznesore);
3. Arbitrazhi.

Programi: Studimet e Avancuara Evropiane (Program në Gjuhë Angleze)

1. European Union Law;
2. Public International Law;
3. Theory of International Law.

Programi: Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale (Program në Gjuhë Angleze):

1. Theory and Practice of Human Rights;
2. Introduction to International Criminal Law (*incl. The history of International Criminal Tribunals*);
3. Introduction to Transitional Justice.

Në studimet postdiplomike-master në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, mund të pranohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor 4 (katër vjeçar), respektivisht 240 ECTS.

Të drejtë konkurrimi kanë vetëm studentët që kanë përfunduar studimet bachelor në drejtimin përkatës (Fakulteti Juridik), me përjashtim të programeve në gjuhë angleze.

Programet në Gjuhë Angleze të Fakultetit Juridik:

Në programet në Gjuhë Angleze, në kuadër të numrit të përgjithshëm për secilin program, do të pranohen deri në 15 studentë ndërkombëtar (5 në programin Studime të Anacuara Evropiane dhe 10 në programin Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale).

Për studentët ndërkombëtar do të shpallet edhe thirrje e veçantë në gjuhë angleze (për secilin program), dhe sipas këtij konkursi për aplikim kërkohet të bashkëlidhen:

- Nje dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- Diplomën/at e studimeve paraprake;

- Letër motivuese referuar në programin që aplikon;
- Dëshmi tjera që mund të jenë relevante për programin nëse kandidati/ja i posedon (dëshmi për njohje të Gjuhës Angleze; certifikata apo dëshmi për kualifikime, etj.).

a) Në Programin Studimet e Avancuara Evropiane (*European Advanced Studies*), të drejtë konkurrimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor në drejtimet: *juridik, ekonomik, shkenca politike, administratë publike, filozofi dhe shkenca siociale*. *Provimi pranues mbahet në gjuhë angleze.*

b) Në Programin Të Drejtat e Njeriut, E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësi Tranzicionale (*Human Rights, International Criminal Law and Transitional Justice*), të drejtë konkurrimi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet Bachelor në drejtimet: *juridik, shkenca politike, administratë publike, ekonomik, psikologji dhe shkenca sociale*. *Provimi pranues mbahet në gjuhë angleze.*

Në këtë program: për studentët ndërkombëtar do të kërkohet plotësimi i formularit të veçantë online (i përgaditur nga UP) sipas kriterëve të këtij konkursi. Afati i aplikimit online për studentët ndërkombëtar do të jetë i hapur nga 18.09.2023 deri me 03.10.2023.

Për studentët ndërkombëtarë, pas përfundimit të aplikimeve Fakulteti organizon një intervistë me kandidatet, dhe sesion informues për programin dhe kushtet e qëndrimit në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit në fuqi.

Vërejtje: Në rast se mbesin vende të lira nga kuota për studentët ndërkombëtarë, atëherë ato vende plotësohen nga kandidatet e rregullt që janë në listën e pritjes dhe e kanë arritur pragun e kalueshmërisë.

V. FAKULTETI EKONOMIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **440** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti Ekonomik	395	45	440
Programi Banka dhe Financa	88	12	100
Programi Menaxhment	88	12	100
Programi Ekonomiks (Gjuhë Shqipe)	73	7	80
Programi Marketing	73	7	80
Programi Kontabilitet	73	7	80

Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:

Për programin Banka dhe Financa, në lëndët:

- a. Financa
- b. Financa të korporatave

Për programin Menaxhment, në lëndët:

- a. Menaxhment
- b. Menaxhment i NVM-ve

Për programin Ekonomiks, në lëndët:

- a. Mikroekonomi
- b. Makroekonomi

Për programin Marketing në lëndët:

- a. Marketing
- b. Sjellje konsumatori

Për programin Kontabilitet në lëndët:

- a. Raportim financiar
- b. Kontabiliteti Menaxherial

VI. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **100** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	89	11	100
Departamenti i Konstruksioneve	35	5	40
Programi Konstruktiv	35	5	40
Departamenti i Hidroteknikës	18	2	20
Programi Hidroteknikë	18	2	20
Departamenti Gjeodezi	18	2	20
Programi Gjeodezi	18	2	20
Departamenti Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU/IWRM)	18	2	20
Programi Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU/IWRM)	Studentë të rregullt	16	20
	Studentë ndërkombëtar	2	

- **Për Programin Konstruktiv, Hidroteknik dhe Gjeodezi**, të drejtë aplikimi kanë studentët të cilët kanë përfunduar studimet bachelor të drejtimeve përkatëse dhe kanë grumbulluar 180 ECTS.
Provimi pranues do të mbahet nga fushat e studimit përkatës ku kandidatët aplikojnë.
- c) **Në Programin Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU/IWRM)**, në kuadër të numrit të përgjithshëm, do të pranohen deri në **2** studentë ndërkombëtarë.

Provimi pranues në Programin Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU/IWRM) mbahet në gjuhën angleze, dhe atë për fushat:

- a) Hidroteknikë (Hydrotechnics),
- b) Inxhinieri e ambientit (Environmental Engineering) dhe/and
- c) Shkenca të natyres (Natural sciences).

Për studentët ndërkombëtarë provimi organizohet në versionin virtual.

Vërejtje: Në rast se mbesin vende të lira nga kuota për studentët ndërkombëtarë, atëherë ato vende plotësohen nga kandidatët e rregullt që janë në listën e pritjes dhe e kanë arritur pragun e kalueshmërisë.

VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **90** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	79	11	90
Programi Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike	27	3	30
Programi Elektronikë, Automatikë dhe Robotikë	26	4	30
Programi Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit	26	4	30

Provimi pranues:

Për secilin nga programet e studimit provimi pranues të organizohet nga “Grup lëndësh profesionale nga fusha përkatëse e studimit”.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **80** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	69	11	80
Programi Termoenergjetikë dhe Energji e Ripërtërishme	26	4	30
Programi Mekatronikë	26	4	30
Programi Dizajn Inxhinierik dhe Automjete	17	3	20

Të drejtë aplikimi kane studentet që kanë përfunduar studimet bachelor ne fushën përkatëse apo të ngjashme dhe kanë grumbulluar 180 apo 240 ECTS.

Provimi pranues mbahet nga fusha e studimit përkatës ku kandidatët aplikojnë.

IX. FAKULTETI I MJEKËSISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **60** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Mjekësisë	52	8	60
Fizioterapi	26	4	30
Edukimi në Kujdesin Shëndetësor MSc (120 ECTS)	26	4	30

Kushtet për aplikim:

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë kandidatët të cilët e kanë kryer Fakultetin e Mjekësisë - niveli baçelor me sistem tre (3) vjeçar.

Për Programin Fizioterapi: kandidatët duhet të jenë të diplomuar në Programin: Fizioterapi.

Për Programin Edukimi në Kujdesin Shëndetësor MSc (120 ECTS), duhet të jetë i diplomuar në njërin prej programeve si në vijim: Infermieri, Mami, ose Fizioterapi.

Provimi pranues për programin Fizioterapi (MSc), mbahet në lëndët: Statistikë dhe metodologji të punës shkencore dhe Gjuhë Angleze.

Provimi pranues për programin Edukimi në Kujdesin Shëndetësor MSc (120 ECTS): mbahet në lëndët: Statistikë dhe metodologji të punës shkencore dhe Gjuhë Angleze dhe Kujdesi infermieror.

X. FAKULTETI I ARTEVE

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **153** studentë dhe atë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Arteve	136	17	153
DEPARTAMENTI I ARTEVE TË BUKURA	44	6	50
Programi i Arteve vizuale	44	6	50
Profili Pikturë	10	2	12
Profili Skulpturë	5	0	5
Profili Grafikë	6	1	7
Profili Arti Konceptual dhe Mediet e Reja	4	1	5
Profili Dizajn i Inovacioneve	7	1	8

Profili Dizajn Komunikimi	7	1	8
Profili Ilustrim dhe Vizatim	5	0	5
DEPARTAMENTI I ARTEVE MUZIKORE	57	6	63
Programi Master i Muzikës në Edukim Muzikor	18	2	20
Profili Edukim muzikor	18	2	20
Programi Master i Muzikës në Performim	36	4	40
Profili Piano	7	1	8
Profili Solo këndim	4	0	4
Profili Dirigjim	1	0	1
Profili Instrumente me harqe dhe tela	11	1	12
Moduli Violinë	3	0	3
Moduli Violë	3	0	3
Moduli Violonçelo	1	1	2
Moduli Kontrabas	2	0	2
Moduli Kitarë	2	0	2
Profili Instrumentet frymore	13	2	15
Moduli Flaut	4	1	5
Moduli Klarinetë	4	1	5
Moduli Saksafon	2	0	2
Moduli Trombon	1	0	1
Moduli Korne	1	0	1
Moduli Tubë	1	0	1
Programi-Master i Muzikës në Kompozim	3	0	3
Profili Kompozim	3	0	3
DEPARTAMENTI I ARTEVE DRAMATIKE	35	5	40
Programi i Arteve Dramatike	35	5	40
Profili Aktrim	11	1	12
Moduli Aktrim në Teatër	6	1	7
Moduli Aktrim në Film/TV	3	0	3
Moduli Aktrim në Performancë	2	0	2
Profili Regji Filmi dhe Televizion	6	1	7
Moduli Regji Filmi dhe Televizion	3	1	4
Moduli Regji e Filmit Dokumentar	3	0	3
Profili Regji Teatri	4	1	5
Moduli Teatri Modern	2	1	3
Moduli Teatri Eksperimental	2	0	2
Profili Dramaturgji dhe Skenar Filmi	7	1	8
Moduli Dramaturgji	2	1	3
Moduli Skenar filmi/TV	3	0	3

Moduli Hulumtim teorik	2	0	2
Profili Dizajn skene dhe kostumografi	7	1	8
Moduli Dizajn skene	3	1	4
Moduli Kostumografi	4	0	4

Kushtet e pranimit:

Kandidatët të cilët konkurojnë në studime pasdiplomike – master në Fakultetin e Arteve duhet të kenë përfunduar studimet themelore 4 vjeçare me 240 ECTS.

Pëprarsi pranimi në Fakultetin e Arteve kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet në këtë fakultet.

Lidhur me ndërrimin e programit të studimeve në studime master vlejshëm dispozitat e konkursit.

Në Departamentin e Arteve Muzikore të Fakultetit të Arteve të Bukura, në programet performuese mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar nivelin bachelor në instrumentin përkatës apo drejtimin/profilin përkatës.

Master i Muzikës në Performim - Profili:

Piano

- J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga ËTC
- 1 Vepër virtuozë;
- 1 Sonatë klasike (Beethoven, një kohë);
- 1 Vepër madhore romantike.

Solo këndim

- 2 Arie (nga repertuari operistik);
- 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë).

Dirigjim

- Dirigjim i veprës për orkestër, për solist ose vokalo instrumentale; (dirigjim public ose DVD) Incizimi duhet të fokusohet në fytyrë (profil) dhe në lëvizjet e duarve të kandidatit, si dhe mundësisht edhe të një pjese të orkestrës. Incizimi duhet të dorëzohet së paku dy ditë para provimit.

Harqe (violin, viole, violonçelo dhe kontrabas)

- J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita;
- 1 Koncert (njëkohë);
- 1 Sontë (njëkohë);
- 1 Pjesë virtuozë.

Kitara

- Bach: 2 kohë nga Partitat ose Sonatat për violin solo;
- H. Villa Lobos: 1 Etidë;
- G. Regondi: 1 Etidë;
- 1 vepër ciliklike (3 ose 4 kohëshe).

Frymor (flaut, klarinet, korne, trombone, tube);

- 1 Koncert (komplet);

- 1 Sonatë (komplet);
- 1 Pjesë virtuoze.

Master i Muzikës - Profili:

Edukim Muzikor

- Provim me shkrim nga lënda: **Metodika e mësimit muzikor**;
- Provim me shkrim nga lënda **Harmoni**.

Kompozim

- Prezentimi i së paku një vepre simfonike ose vepre vokalo-instrumentale nga vet aplikuesit;
- Provim me shkrim nga lënda **Kompozim** (kompozimi i veprës së përbërë 3 pjesore ose variacione mbi temën e dhënë).

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **65** studentë dhe atë në programet si në vijim:

Departamenti-Programi	Per studime te rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë	58	7	65
Programi Shkencat e aplikuara në zootekni	13	2	15
Programi Ekonomia e bujqësisë dhe ushqimit	18	2	20
Programi Mbrojtja e bimëve- Fitomedicinë	9	1	10
Programi Pemëtari me Vreshtari	9	1	10
Programi Shkencë bimore	9	1	10

Provimi pranues do të mbahet nga lëndët profesionale të drejtimeve përkatëse.

XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **95** studentë:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit	83	12	95
Programi Edukim Fizik dhe Sport, programi 2 vjeçar	35	5	40
Programi Edukim Fizik dhe Sport, programi 1 vjeçar	22	3	25
Programi Trajner Sportiv, programi 1 vjeçar	26	4	30

Provimi pranues:

Provimi pranues organizohet nga fusha e Edukimit Fizik dhe Sportit.

Kandidatët që konkurrojnë në studimet Master, duhet të kenë të përfunduar studimet themelore me 180/240 ECTS në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit.

XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT

Në vitin e parë të studimeve do të regjistroj **380** studentë dhe atë në programet si në vijim:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Edukimit	334	46	380
Departamenti i Pedagogjisë	124	16	140
Programi: Master në Shkenca të Edukimit	124	16	140
Master në Shkenca të Edukimit: Këshillim Pedagogjik	31	4	35
Master në Shkenca të Edukimit: Edukim Inkluziv	31	4	35
Master në Shkenca të Edukimit: Mësimdhënia dhe Kurrikula	31	4	35
Master në Shkenca të Edukimit: Udhëheqja në Arsim	31	4	35
Departamenti Mësimdhënies Lëndore	210	30	240
Programi Master i Mësimdhënies Lëndore	210	30	240
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Matematikës	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Fizikës	18	2	20
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Kimisë	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Biologjisë	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Historisë	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjeografisë	18	2	20
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut	26	4	30
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	26	4	30
Master i Edukimit për STEAM	18	2	20

Provimi pranues dhe kushtet e aplikimit sipas programeve:

MASTER NË SHKENCA TË EDUKIMIT, MA 120 ECTS:

- **Master në Shkenca të Edukimit: Këshillim Pedagogjik, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në drejtimet Pedagogji e Përgjithshme, Pedagogji Sociale, Pedagogji Speciale, Psikologji, Sociologji,

Punë Sociale, Edukim Fillor, Edukim Parashkollor dhe Edukim në Fëmijëri të Hershme në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e pedagogjisë, psikologjisë dhe shkathtësive analitike.

- **Master në Shkenca të Edukimit: Edukim Inkluziv, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në drejtimet Pedagogji e Përgjithshme, Pedagogji Sociale, Pedagogji Speciale, Psikologji, Sociologji, Punë Sociale, Edukim Fillor, Edukim Parashkollor dhe Edukim në Fëmijëri të Hershme si dhe në programet tjera arsimore të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.
Testi pranues do të organizohet nga fusha e edukimit inkluziv, pedagogjisë, psikologjisë dhe shkathtësive analitike.
- **Master në Shkenca të Edukimit: Mësimdhënia dhe Kurrikula, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetet e Edukimit si dhe në programet tjera arsimore të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.
Testi pranues do të organizohet nga fusha e mësimdhënies/kurrikulës, pedagogjisë dhe shkathtësive analitike.
- **Master në Shkenca të Edukimit: Udhëheqja në Arsim, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetet e Edukimit si dhe në programet tjera arsimore të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.
Testi pranues do të organizohet nga fusha e udhëheqjes dhe politikave arsimore, pedagogjisë, psikologjisë dhe shkathtësive analitike.

MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE:

- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Matematikës, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Matematikë-Informatikë) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore – Programi i Matematikës.
Testi pranues do të organizohet nga fusha e matematikës, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Fizikës, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Fizikë- Kimi) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore – Programi i Fizikës.
Testi pranues do të organizohet nga fusha e fizikës, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.
- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Kimisë, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programet Biologji-Kimi dhe Fizikë-Kimi) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore - Dega e Kimisë.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e kimisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.

- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Biologjisë, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Biologji-Kimi) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore – Programi i Biologjisë.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e biologjisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.

- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Historisë, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Histori- Edukatë Qytetare) dhe në Fakultetin Filozofik - Dega e Historisë.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e historisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.

- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjeografisë, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Gjeografi-Edukatë Qytetare) dhe në Fakultetin e Shkencave Matematiko- Natyrore - Dega e Gjeografisë.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e gjeografisë, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.

- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Teknologji-Informatikë) dhe kandidatët e tjerë nga programet e akredituara të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës- të cilët gjatë studimeve themelore kanë së paku 100ECTS nga Informatika (të cilën duhet ta dëshmojnë me certifikatë të notave të studimeve themelore).

Testi pranues do të organizohet nga fusha e teknologjisë, TIKut, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.

- **Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, MA 120 ECTS:** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në Fakultetin e Edukimit (Programi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe) në Fakultetin e Filologjisë (Programet Gjuhë shqipe dhe Letërsi shqipe), si dhe në programet e akredituara për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe të Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës.

Testi pranues do të organizohet nga fusha e gjuhës dhe letërsisë Shqipe, si dhe nga fusha e shkathtësive analitike.

MASTER I EDUKIMIT PËR STEAM (120 ECTS)

- **Master i Edukimit për STEAM (120 ECTS):** Mund të aplikojnë kandidatët që kanë mbaruar studimet BA me së paku 180 ECTS në profilet: Edukimi parashkollor, Edukimi

fillor dhe profilet tjera në fushën STEAM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Arte dhe Matematikë).

Testi pranues do të organizohet nga fusha e shkencës, matematikës dhe teknologjisë (konteksti i jetës së përditshme), si dhe nga fusha e shkathësive analitike.

XIV. FAKULTETI I ARKITEKTURËS

Në vitin e parë të studimeve do të regjistroj **80** studentë dhe atë në programet si në vijim:

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Gjithsej
Fakulteti i Arkitekturës	70	10	80
Programi Arkitekturë	44	6	50
Programi Eficiencë e Energjisë	26	4	30

Për programin studimor MSc Arkitekturë me specializime, kandidatët që kanë përfunduar studimet bachelor në arkitekturë dhe urbanistikë dhe kanë grumbulluar më së paku 180 ECTS.

Krahas dokumentacionit të nevojshëm për aplikim online dhe fizik, pika III.5, kandidatët duhet të plotësojnë deklaratën e prioriteteve prej 1 deri 5 për pesë specializimet që ofrohen në këtë program studimor. Numri i kuotave në specializime është i kufizuar.

